

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Noemi money transfer services” shpk,**

Ne Lushnje, sot ne date 05/01/2021 :

Me cilesine e “ortakut te vetem themelues” :

- **Z.Fatos Liço**,i biri i Habil, i datelindjes 09.06.1964 ,lindur dhe banues ne Lushnje ne Bashkine Divjake, Qarku Fier, Shqiperi, shtetas shqiptar, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. G40609047T; me vullnet të lire të plete e të sinqerte, kane redaktuar këtë statut ne respekt te : Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “, Ne ligjin “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit ”, ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, ka themeluar një Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin **“Noemi money transfer services” shpk**, (me poshte e quajtur “ Shoqeria ”).

*Neni 1 Emertimi*

Shoqeria gezon emrin **“Noemi money transfer services” shpk**, dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , me poshte e quajtur “Shoqeria”),por emertimi i shkurtuar dhe i njohur i shoqerise do te jetë **“Noemi MTS” shpk**  
Shoqeria miraton dhe perdor logon,vulen,emrin tregtar,shumen e kapitalit te nenshkruar, NIPT-in dhe cdo te dhene tjeter qe e identifikon ate ne mardhenie me te trete

*Neni 2 Personaliteti juridik*

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet, kontratat dhe procedurat e parashikuara me ligj per paisjen me licensat perkatese per ushtrim aktiviteti .

Shoqeria **“Noemi MTS” shpk** është një shoqëri tregtare, e krijuar sipas ligjit te shoqerive tregtare dhe si e tille nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

*Neni 3 Selia*

Shoqeria e ka seline ne Divjake ,Lagja nr 1 Rruga Demokracia, ndertese 11,zk 1922, Bashkia Divjake ,Qarku Fier, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te vetem .

*Neni 4 Objekti i reprimtarise*

Veprimitari te agjentit per transferta parash, sherbimin e pagesave, komisionerit si dhe MoneyGram



Albania ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke. Veprimtari si agjent Imobiliar, ushtrim i veprimtarise te ndermjetesimit ne sigurime, ushtrimi i veprimtarise se agjentit te udhetimeve, ushtrimi i veprimtarise se guidave turistike, ushtrimi i veprimtarise si agjent postar, ushtrim i veprimtarise se agjentit te shoqerive telefonike dhe celulare, ushtrim i veprimtarise se kembimit valutor, ushtrim i veprimtarise se ndermjetsimit te pagesave utilitare. Shoqeria ka te drejte te kryej sherbimet e transfertave te parave, sherbimin e pagesave, komisionerit dhe shkembimit te vlerave monetare(exchange) per llogari te saj apo te cdo subjekti financiar jobanke, si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar me ligjesi dhe cdo aktivitet te lejuar nga ligji.

#### Neni 5 Kovezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për një periudhë kohe te pakufizuar. Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes së Ortakut te vetem te shoqërisë

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET**

#### Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i pataksueshem i shoqerise eshte 3.000.000(tre milione)leke, 1(nje) kuote. Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga ortaku i shoqerise :

**Z. Fatos Liço**, zoterues i 1(nje) kuota me vlere te pergjithshme 3.000.000(tre milione)leke, qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise .

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut, mund të jetë në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) edhe në para (cash).

#### Neni 7 Zmadhimi dbe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Ortakut te Vetem të thirrur për të marrë vendim rrëth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar me ligje apo te ketij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast mosbatimi të kërkesave të këtij paragarfi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendim.

#### Neni 8 Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata mes paleve duhet të bëhet me shkrim me ose pa pranine e një Noteri.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

### **KAPITULLI III ORTAKU I VETEM, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTI KONTABËL**

#### *Neni 9 Organ i Vendimmarres*

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

*Ortaku i vetem, vendos përfshirje si :*

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet përiorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Vendimet e ortakut jane te detyrueshme per zbatim nga ana e drejtimit te shoqerise.

#### *Neni 10 Administrimi*



Administrator i shoqerise emerohet ne detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.  
Administratori i pare i shoqerise do jete z/znj Fatos Lico, e datelindjes 09.06.1964, banues ne Divjake , Bashkia Divjake,Qarku Fier,Shqiperi, shtetas shqiptar, madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. G40609047T.  
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

#### Neni 11 Kompetencat

*Administratori ka të drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit si dhe te publikoje cdo vendim qe ka efekte per shoqerine;
  - e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Administratori ka të drejtë të krye të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përpunhje me objektin e saj. Administratori eshte i detyruar te zbatoj venimin e ortakut te vetem,kjo edhe ne rastet kur mendimi i tij eshte i ndryshem

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 12 Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në



mjedis;

- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrate të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) i kthen ortakut kontributet;
- b) i paguan ortakut interesa apo dividendë;
- c) i shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

#### Neni 13 Viti Financiar

Ekspertet kontabel te shoqerise kane te drejte te kontrollojnë te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike-tregtare te shoqerise garkuar te kryej një detyre te tille nga Ortaku i shoqerise.

Raporti i ekspertit kontabel se bashku me pasqyrat financiare te miratuara te shoqerise paraqitet per miratim nga Ortaku i shoqerise.

### **KAPITULLI V DIVIDENTI, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË, MOSMARVESHJET**

#### Neni 14 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

#### Neni 15 Bilanci i shoqerise dbe dividentet



Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton pasqyrat financiare te paraqitur nga Administratori. Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos per shperndarjen e dividentit pas miratimit te pasqyrave financiare dhe ne cdo kohe qe e shikon te arsyeshme deh bazuar ne ligje dhe statusin fiskal te aktivitetit. Oratku mund te krijoj rezerva statuore ne masen 10% te kapitaleve te veta, rezerva ligure ne masen 10% te kapitalit te shoqerise dhe rezerva per kerkime dhe studime ne masen 5% te kapitaleve te veta, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### Neni 16 Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 17 Likujdimi

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji.

Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtronet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 18 Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata e rrëthit Gjyqesor,Tirane.

Shoqëria "**Noemi MTS**" shpk  
ORTAKU I VETEM

Fatos Liço  
